

MINISTRI

Z. Ylli Manjani ka përfunduar studimet e larta për Drejtësi pranë Universitetit të Tiranës, ndërsa studimet pasuniversitare i ka kryer në Universitetin e Oslos dhe Universitetin Leiden në studime të specializuara për të Drejtën Evropiane.

Angazhimi i tij politik përfshin aktivizimin si nënkryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim të Shqipërisë dhe Anëtar i Kuvendit, Sekretar për Zgjedhjet i Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Z. Manjani ka një përvojë të gjerë në administratën publike, organizata ndërkombëtare dhe institutet kërkimore ligjore. Ndër postet më të rëndësishme të mbajtura prej tij janë ato të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, Këshilltar Juridik dhe Politik i Kryeministrit të Shqipërisë dhe Zëvendësministër, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Është gjithashtu i përfshirë në fushën akademike, ku vlen të theksohet angazhimi si lektor dhe autor i librave: E Drejta Administrative për Studentët dhe Komentar për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Zëvendësministër i Drejtësisë

Arben Isaraj, i biri i Violetës dhe Astritit, ka lindur në Vlorë më 21 prill 1966 dhe banon në Tiranë. Është i martuar me Elona Isaraj (Dilo) dhe kanë dy fëmijë, Flavion dhe Fionën.

Arben Isaraj ka një karrierë të gjatë e të larmishme akademike, administrative dhe politike.

Pasi ka kryer studimet e larta për Drejtësi, në vitin 1988-të diplomohet “Jurist”, dhe nga viti 1989-të deri në vitin 2002, ai ka qenë asistent dhe pedagog i lëndëve “Histori e Doktrinës Politike-Juridike” e “Filozofi e së Drejtës” si dhe Zëvendësdekan në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Në mbi 10 vjet si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë, ai është specializuar dhe kualifikuar në fushën e mendimit politik e juridik në Angli, Francë, Gjermani, Itali, Belgjikë, Greqi etj, si dhe ka qenë autor e bashkëautor punimesh, artikujsh shkencor si dhe tekstesh universitare mbi të drejtën dhe ligjin. Sot është pedagog i jashtëm në Shkollën e Magjistraturës, për lëndën “Etika Profesionale”.

Jeta e tij aktive politike dhe publike, zë fill në vitin 1998-të me emërimin dhe e ushtrimin e detyrave si Këshilltar Juridik dhe Këshilltar i Sigurisë Kombëtare i disa Kryeministrave dhe ministrit të Mbrojtjes, Inspektor i Përgjithshëm i Shërbimit Informativ Shtetëror, Zëvendësministër i Rendit Publik.

Në zgjedhjet parlamentare mazhoritare të vitit 2005-së, Arben Isaraj kandidoi për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, me mbështetjen e Partisë Socialiste, duke shënuar një fitore direkte ndaj rivalit të tij, në zonën zgjedhore nr.95, Qarku Vlorë. Ai kryesoi në vitin 2009-të listën zgjedhore parlamentare në Qarkun e Vlorës duke fituar mandatin e dytë si përfaqësues i popullit.

Gjatë këtyre dy mandateve si deputet i Kuvendit të Shqipërisë (2005-2013) si dhe sekretar e nënkryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Arben Isaraj ishte pjesë përbërëse e komisioneve të përhershme kuvendore të ligjeve dhe sigurisë kombëtare si dhe kryetar e bashkëkryetar i disa komisioneve të posaçme hetimore kuvendore.

Si përfaqësues i popullit në Kuvend dhe anëtar i Kryesisë së Partisë Socialiste në dy mandate, gjatë 8-të viteve në opozitë, pas fitores plebishitare të 23 qershorit 2013-të, Arben Isaraj emërohet Zëvendësministër i Drejtësisë.

